



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.860/22

GJYKATA KOMERCIALE-Dhoma e Shkallës së Dytë,në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të falimentimit debitorit, me seli në Prishtinë, me numër të regjistrimit të biznesit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat Skender Musa nga Prishtina ndaj kreditorës Administrata Tatimore e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit L.GJ juriste nga Prishtina duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EF.nr.2/21 e datës 20/01/2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 31/08/2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e Administrata Tatimore e Kosovës, me seli në Prishtinë, **ANULOHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, .EF.nr.2/21 e datës 20/01/2022, dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale Dhomës së Shkallës Parë parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin ankimor EF.nr.2/21 e datës 20/01/2022, ka vendosur që të përfundoj procedurën e falimentimit të debitorit, me seli në Prishtinë, me numër të regjistrimit të biznesit, me konstatimin se gjatë procedurës së falimentimit, nuk është identifikuar ndonjë pasuri në pronësi apo zotërim faktik të debitorit të falimentimit, e as mjete të gatshme financiare, të cilat do të mund të ishin objekt i shitjes e i shlyerjes të detyrimeve të kësaj shoqërie tregtare.

Gjithashtu në dispozitiv të aktvendimit është konstatuar se në procedurën e falimentimit është paraqitur dhe aprovuar si kreditor ATK, kërkesa e së cilës nuk është përmbushur për shkak të mungesës së mjeteve financiare në fondin e likuidimit si dhe detyrohet ARBK, që ta fshij debitorin e falimentimit nga regjistri i bizneseve, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit si dhe është detyruar debitori i falimentimit të paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej 495.00 euro në emër të shpërblimit të administratorit të falimentimit

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori Administrata Tatimore e Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale dhe të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar ndërsa aktvendimi i atakuar të priset.

Propozuesi i falimentimit-debitori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesi i falimentimit-debitori ..., me seli në Prishtinë, me numër të regjistrimit të biznesit ..., në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datë 24.03.2021 ka paraqitur propozim për iniciimin e procedurës së falimentimit.

Në propozimin për fillimin e falimentimit ka cekur se debitori është zhytur në borxhe dhe në pamundësi për ti kryer obligimet ndaj kreditorit ku shuma e përgjithshme e obligimeve ndaj kreditorit e kalon borxhin mbi 30,568.91 euro (tridhjetë mijë e pesëqind e tetë euro e nëntëdhjetë e një euro), si pasojë e këtij borxhi debitorit të falimentimit nuk i ka mbetur tjetër përveç të hapet procedura e falimentimit, eventualisht edhe riorganizimit të ndërmarrjes nëse krijohen kushtet për kryerjen e obligimeve. Propozimit i ka bashkangjitur edhe provat përkatëse me të cilat ka pretenduar të arsyetoj propozimin për fillimin e falimentimit

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin për iniciimin e procedurës së falimentimit ka mbajtur seancën dëgjimore me datë 18.05.2021 dhe ndërgjyqësit i kanë paraqitur pretendimet e tyre sa i përket bazueshmërisë së propozimit dhe pas përfundimit të seancës gjyqësore, me datë 12.07.2021 ka marrë aktvendim për caktimin e administratorit të falimentimit dhe për fillimin e procedurës së falimentimit, ndërsa administratori me raportin e datës 21.09.2021 ka informuar gjykatën me ecurinë e procedurës.

Gjykata me datën 10.12.2021 ka mbajtur seancën e radhës ku administratori i falimentimit ka paraqitur raportin si vijon: pas fillimit të procedurës së falimentimit kam ndërmarrë hapat ligjor dhe procedural duke bërë njoftimin publik në dy gazeta zyrtare Koha dhe Zëri me datë 20.07.2021. Ka shtuar se pas kalimit të afatit të publikimit prej 60 ditësh ka pasur vetëm një kërkesë kreditore dhe atë nga ATK-ja. Ka shtuar se biznesi i debitorit është në gjendje të rëndë financiare dhe se i njëjti nuk ka asete dhe mjete financiare në llogaritë bankare. Ka shtuar se është çështje e gjykatës po konsideroj se nuk ka komunitet të kreditorëve për faktin se nuk ka kreditorë të deklaruar përveç ATK-së. Tutje ka konstatuar se debitori nuk ka paraqitur kërkesë për riorganizim dhe në këtë situatë konsideroj se është e pamundshme që i njëjti debitor të riorganizohet se edhe po të shkonte në riorganizim nuk ka asnjë garancë të rimëkëmbet apo kreditorët do të mund të realizonin kërkesat e tyre në të ardhmen.

Gjykata e shkallës së parë ka marr aktvendimin e ankimuar duke u bazuar në dispozitën e nenit 103 par.2 të Ligjit të Falimentimit dhe duke e arsyetuar aktvendimin e ankimuar se në rastin konkret janë plotësuar përfundimin e procedurës së falimentimit.

Gjykata Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë sipas detyrës zyrtare, e në bazë të nenit 194 të LPK, e vlerëson aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve ankimore të theksuara në ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 nën pikën b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka gjetur se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par. 2 pikën n), për arsye se aktvendimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm, jo i plotë, kontradiktor dhe i pa-ekzekutueshëm.

Shkelja e tillë përfaqëson shkelje thelbësore të dispozitës së nenit 182 par. 2 pika n) të Ligjit të procedurës kontestimore që ka pasur ndikim në marrjen e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktvendimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Në arsyetimin e aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë përveç përshkrimit të procedurës dhe deklarimeve të palëve, nuk ka dhënë arsye të qarta për faktet vendimtare në bazë të të cilave ka marrë vendimin e atakuar, por është mjaftuar vetëm me referimin në disa prova në mënyrë të përgjithësuar, pa sqaruar se nga cilat prova konkrete cilat fakte janë vërtetuar, e po ashtu në mënyrë të përgjithësuar është referuar ne dispozitat ligjore të Ligjit për Likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridik në Falimentim.

Sipas Nenit 8.2 të LPK-së, gjykata ka për obligim që me ndërgjegje dhe me kujdes ta çmojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku për të ardhur te e vërteta materiale. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka vendosur për kundërshtimet e palëve pa qartësuar plotësisht gjendjen faktike dhe juridike të çështjes respektivisht pa i vërtetuar me prova konkrete faktet vendimtare kontestuese sepse nga arsyetimi i aktvendimit të atakuar nuk është e qartë se si gjykata e shkallës së parë ka ardhur te përfundimi se kërkesat e palëve janë të bazuara.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë , me një kujdes të shtuar i ka analizuar edhe pretendimet tjera ankimore në raport me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe erdh në përfundim se këto pretendime qëndrojnë sepse AF gjatë shqyrtimit të rastit, nuk ka analizuar nëse kërkesa e debitorit për inicimin vullnetar të falimentimit është parashtruar ashtu siç është përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-083 Për Falimentimin, nenin 30 respektivisht nenin 31 paragrafi 1.5 dhe nenin 32 të këtij ligji.

Gjykata ne dispozitivin e aktvendimit nuk ka vendos/urdhëruar moratoriumin dhe ndërprerjen e të gjitha veprimeve të përcaktuar me Nenin 33 të Ligjit nr. 2003/4 – Për Likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik në falimentim, por është mjaftuar me cekjen e këtij elementi në arsyetimin e aktvendimit, me një formulim “ve në pah”. Gjykata ka për detyrë që në

dispozitivin e vendimit të jap urdhra konkret lidhur me çështjen sepse theksimet nga arsyetimi nuk obligojnë palët dhe janë të pa ekzekutueshëm.

Gjykata e shkallës së parë gjithashtu në dispozitivin e aktvendimit nuk ka vendos/urdhëruar ashtu sic parashihet në nenin 25 par 2.1 të Ligjit mbi falimentimin ashtu që të njoftojë brenda dy (2) ditëve regjistrin e bizneseve, regjistrin e pengut, bankat komerciale, regjistrin e kredive të Bankës Qendrore dhe administratën tatimore për hapjen e rastit, ku thuhet se “ pas pranimit të njoftimit nga gjykata, regjistri i bizneseve, regjistri i pengut, bankat komerciale, regjistri i kredive dhe administrata tatimore do të shënojnë në regjistrat e tyre fillimin e procedurës së falimentimit”, ndërsa në rastin konkret Administratori i Falimentimit gjatë përpilimit të raportit nuk ka konstatuar apo verifikuar raportet bankare nga Banka Qendrore e Kosovës, për të vërtetuar faktin se a janë bërë transaksione në mënyrë të rregullt e nëse nuk janë bërë në mënyrë të rregullt në kuptim të nenin 37 të ligjit për falimentim, këto transaksione duhet të anulohen.

Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur apo kanë mundur të kenë ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktvendimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në ri-procedurë t'i evitoj të gjitha të metat të cekura më lartë, t'i vërtetoi faktet relevante të sipërpërmendura, ta ftoj administratorin e falimentimit që ta plotësoj raportin, t'i vlerësojë dhe analizojë të gjitha provat e nevojshme për të vlerësuar bazueshmërinë e kundërshtimeve të palëve, ashtu që pastaj, të vendos drejt dhe sipas Ligjit.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, al.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.860/22, data 31.08.2022

**Kryetarja e kolegjit-Gjyqtarja
Saranda Bogaj Sheremeti dv.**